

Fletë informuese mbi rregulloren kushtetuese liberale dhe demokratike

Sot, ju deklaroni angazhimin tuaj ndaj rregullores kushtetuese liberale dhe demokratike të Republikës Federale të Gjermanisë. Ky është kriter për të aplikuar për të drejtën e qëndrimit (Chancen-Aufenthaltsrecht) (Ileje qëndrimi në përputhje me nenin 104c, paragrafi 1, fjalia 1, nr.1). E drejta e qëndrimit (Chancen-Aufenthaltsrecht) ju jep mundësinë të përmbushni kushtet për një qëndrim mundësisht të përhershëm dhe të ligjshëm në Gjermani.

Për të qenë në gjendje të fitoni të drejtën e qëndrimit, duhet të njihni vlerat që përcaktojnë bashkëjetesën e njerëzve në Gjermani. Sepse edhe nga ju pritët të respektohen këto vlera. Në të njëjtën kohë, ju mund të përfitoni në jetën tuaj të përditshme nga avantazhet që lidhen me këto vlera vetëm nëse i njihni ato.

Koncepti i rregullores kushtetuese liberale dhe demokratike, ndaj të cilit sot angazhoheni, përshkruan tërësinë e këtyre vlerave. Vlerat janë të vendosura nga Ligji Themelor, siç quhet Kushtetuta e Republikës Federale të Gjermanisë.

Në veçanti për sa vijon, duhet të kuptoni rregulloren kushtetuese liberale dhe demokratike, të angazhoheni si dhe t'i përmbaheni asaj pa rezerva:

Gjermania është demokraci parlamentare. Populli do të zgjedhë personalisht përfaqësuesit e tij nëpërmjet votimit universal, të drejtpërdrejtë, të lirë, të barabartë dhe të fshehtë. Asnjë person që ka të drejtë vote nuk mund të ndalohet për ta shprehur atë. Çdo votë ka vlerë dhe të gjitha votat kanë të njëjtën peshë. Askush nuk mund të ndikohet kundër vullnetit të tij në shprehjen e një vote. Asnjë person tjetër nuk ka të drejtë të dijë për kë keni votuar.

Në Gjermani lejohen shumë parti politike, të cilat mund të përfaqësojnë interesa dhe orientime shumë të ndryshme. Të gjitha partitë kanë të njëjtat mundësi për fushatë dhe kandidim, me qëllim që të realizojnë idetë e tyre politike. Partitë duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e Ligjit Themelor në vendosjen e qëllimeve dhe në veprimet, me të cilat i ndjekin ato.

Bundestagu është përfaqësimi i popullit (parlamenti) në nivelin më të lartë të qeverisjes. Vendos me votën e shumicës se kush do të udhëheqë qeverinë federale si Bundeskanzler ose Bundeskanzlerin (Kancelar/e Federal/e). Qeveria federale drejton punët politike dhe kontrollohet nga *Bundestagu*. Partitë që nuk janë përfshirë në qeveri kanë një funksion të rëndësishëm kontrolli ndaj qeverisë si opozitë në parlament. Qeveria mund të mos votohet përsëri nga parlamenti dhe zgjedhjet dhe mund të zëvendësohet në mënyrë paqësore.

Gjermania është një shtet kushtetues. *Bundestagu* miraton ligjet që janë të vlefshme për të gjithë Gjermaninë. Në disa raste, kjo kërkon miratimin e landeve federale. Ligjet duhet të jenë gjithmonë në përputhje me Ligjin Themelor. Po ashtu, të gjitha aktgjykimet dhe vendimet e gjykatave gjermane duhet të jenë në përputhje me Ligjin Themelor. Ky aspekt shqyrtohet nga Gjykata Federale Kushtetuese si gjykata më e lartë gjermane. Të gjitha gjykatat në Gjermani janë të lidhura me ligjin. Gjykatat janë gjithsesi të pavarura dhe nuk mund të ndikohen në vendimet e tyre, as nga qeveria as nga autoritetet. Përpara gjykatës, kushdo ka të drejta të njëjta, pavarësisht origjinës, burimeve financiare apo pozicionit në shoqëri.

Detyrat e administratës së përgjithshme kryhen nga autoritetet shtetërore dhe lokale. Autoritetet gjithashtu janë të lidhura me ligjet dhe mund të veprojnë vetëm në bazë të tij.

Ligjet kanë të njëjtën vlerë për të gjithë njerëzit. Çdo person që preket nga një vendim zyrtar mund të kërkojë rishqyrtimin e tij nga një gjykatë.

Në Gjermani, askush nuk mund të ushtrojë kontroll me dhunë mbi shtetin ose mbi njerëzit. Masat shtrënguese mund të kryhen vetëm nga agjencitë qeveritare, siç është policia dhe vetëm si mjet i fundit. Megjithatë, kjo lejohet vetëm në përputhje me ligjin. Çdo masë mund të shqyrtohet nga gjykatat dhe madje të ndalohet.

Në Gjermani, të drejtat dhe liritë e njeriut respektohen dhe mbrohen nga shteti. Të drejtat e njeriut të garantuara nga Ligji Themelor janë të pashkelshme, veçanërisht dinjiteti njerëzor dhe e drejta për jetën dhe integritetin fizik.

E njëjta gjë vlen edhe për zhvillimin e lirë të personalitetit, që do të thotë se çdo person i përcakton personalisht vendimet dhe veprimet e veta. Megjithatë, të drejtat e personave të tjerë nuk mund të kërcënohen dhe ligjet nuk mund të shkelen. Në Gjermani, të gjithë qytetarët janë të lirë të shprehin mendimet e tyre, por nuk mund të nxisin urrejtjen dhe dhunën ndaj atyre që nuk ndajnë të njëjtat mendime. Protestat dhe demonstrimet publike janë të lejuara, por duhet të jenë paqësore.

Ligji Themelor gjithashtu garanton barazinë e të gjithë njerëzve. Askush nuk mund të diskriminohet, të persekutohet ose të vihet në disavantazh në çfarëdo mënyre, qoftë për shkak të origjinës, besimit, aftësive të kufizuara ose ideologjisë. Një veprim me qëllime antisemite, raciste, ksenofobe ose qëllime tjera jo njerëzore nuk është i përputhshëm me këtë ligj dhe është në kundërshtim me këtë deklaratë.

Të gjitha gjinitë janë të barabarta. Gratë, burrat dhe personat me gjini të ndryshme kanë të njëjtat të drejta. Askush nuk mund të diskriminohet, të persekutohet në asnjë mënyrë apo të vihet në rrezik për shkak të përkatësisë së tij gjinore apo të orientimit seksual. Personat që kanë një stil jetese ndryshe nga i juaji duhet të trajtohen me respekt dhe tolerancë.

Kursi i orientimit ofron njohuri të mëtejshme të rëndësishme në lidhje me sistemin ligjor, por edhe në lidhje me kulturën dhe historinë e Gjermanisë. Kursi i orientimit është pjesë e kursit të integritetit. Pas lëshimit të së drejtës së qëndrimit, keni të drejtë të merrni pjesë në kursin e integritetit ose do e keni të detyrueshme të merrni pjesë.

Ju mund të informoheni gjithashtu për jetën në Gjermani duke konsultuar burime të besueshme, si portali i qeverisë federale <https://www.make-it-in-germany.com/de/leben-in-deutschland/deutschland-kennenlernen/deutsche-gesellschaft> i Zyrës federale për migracionin dhe refugjatët

<https://www.bamf.de/DE/Themen/Integration/ZugewanderteTeilnehmende/ErsteOrientierung/UnserGrundgesetz/unser-grundgesetz-node.html> ose në Zyrën Federale për edukimin politik <https://www.bpb.de>.